



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DURRES

Nr. 124 prot

Durres, me date 31.01 2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
Qendra e Formimit Profesional Publik Durres ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet :

1. Mesimdhënes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Kujdestar Social ” prane QFPP Durres (1 person)
2. Mesimdhënes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Kujdestar femijesh ” prane QFPP Durres (1 person)
3. Mesimdhënes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Grafik Dizajn ” prane QFPP Durres (1 person)
4. Mesimdhënes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Pasticeri ” prane QFPP Durres (1 person)
5. Mesimdhënes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Instalime dhe mirembajtje e rrjetit hidraulik ” prane QFPP Durres (1 person)

6. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Parukeri” prane QFPP Durres (1 person)
7. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Kuzhine ” prane QFPP Durres (1 person)
8. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Manikyr - pedikyr ” prane QFPP Durres (1 person)
9. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Rrobaqepesi” prane QFPP Durres (1 person)
10. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Instalime dhe mirembajtje e rrjetit elektrik ” prane QFPP Durres (1 person)
11. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Bojatisje” prane QFPP Durres (1 person)
12. Mesimdhenes me kohe te pjesshme I formimit teorik-praktik per kursin “ Perpunim peshku” prane QFPP Durres (1 person)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formë së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;

- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e QFPP Durrës , brenda datës 09.02.2024 .

DREJTORI

AGIM KARAJ

